REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E KULTURËS

KALENDARI ARTISITIK
QERSHOR 2023



"ËNDRRA IME, RINA"

Komedi romantike

Data: 01-04.06.2023; 08-11.06.2023; 15-18.06.2023; 22-25.06.2023

Ora: 20:00



Vendi: Teatri Kombëtar, salla "Central 400", ArTurbina, Tiranë
Autor: Pëllumb Kulla
Regjisor: Spiro Duni
Produksion i Teatrit Kombëtar
Një regjisor teatri në prag pensioni dhe në prag divorci me gruan e tij, dhe situatat e ndryshme që krijohen nga ndërveprimet e tij me familjen, fëmijët dhe personazhet e ndryshme që vijnë në shtëpinë e tij për të kërkuar ndihmë profesionale. Një vështrim komik mbi familjen, problemet e saj dhe dukuritë sociale bashkëkohore.

"BREKËT"

Data: 07.06.2023

Ora: 19:00

Vendi: TKEKS - Qendra "Tirana Art", Arturbina, Salla 150
"Brekët" është projekt artistiko-humoristik, i cili transmeton mesazhe kundër dhunës dhe formave të ndryshme të saj, ndaj grave dhe vajzave.
Ky projekt ka në fokus ndërgjegjësimin, parandalimin e dhunës, zvogëlimin e paragjykimeve ndaj vajzave dhe grave. Komedia "Brekët" implementohet nga Qendra "Tirana Art", dhe zbatohet me mbështetjen e projektit rajonal "SMART Balkans – Shoqëria Civile për Vlera të Përbashkëta në Ballkanin Perëndimor", i zbatuar nga Centar za promociju civilnog društva (CPCD) në partneritet me Institutin për Demokraci dhe Ndërmjetësim (IDM) dhe Center for Research and Policy Making (CRPM) dhe i mbështetur financiarisht nga Ministria e Punëve të Jashtme të Norvegjisë (NMFA).

“NGA E ENJTJA NË TË ENJTE”

Produksion i Teatrit “Skampa”, Elbasan

Data: 14-15.06.2023

Ora: 20:00

Vendi: Arturbina, Salla 150, TKEKS
Regjia: Milto Kutali
Me aktorët: Alfred Trebicka, Ilirda Bejleri, Egla Ceno, Klajdi Malellari, Marsias Lila, Flobensa Bezati.

“TANI KENI SY PËR TA PARË”

Data: 16.06.2023

Ora: 19:00

Vendi: Teatri “ Petro Marko”, Vlorë

“Tani keni sy për ta parë ” sjell në vëmendje mënyrat e ndryshme se si figura e gruas trajtohet si e padukshme në kulturën tonë. Ato kërcejnë, këndojnë dhe tregojnë metamorfozën mentale dhe fizike që gruaja përjeton në katër stinët e vitit. Zëri i gruas është sfidues. Pyetja e grave në skenë është e thjeshtë: Si dhe pse e lejojmë që fuqia jonë të zhduket pa luftuar? Gjashtë gra, të cilat rrëfejnë historinë e tyre: Joanne sjell në vëmendje sfidat e gazetareve gra, Flo nëna e dy fëmijë tregon përpjekjet e saj për të ndër-tuar një karrierë si artiste, Dez e gjendur në një periudhë tranzit në jetën e saj duhet të marrë një vendim, Kate një mikrobiologe e pasionuar merr vesh që ka mbetur shtatzënë dhe gjendet përballë vendimit ta mbajë fëmi-jën apo të vazhdojë me studimin e saj në Brazil për të realizuar një reportazh që do të mbajë emrin e saj, Jennie përballet me depresionin pas lindjes, por dhe me dashurinë e madhe që ka për foshnjën e saj, Darya e lirë nga patriarkati, gati një figurë mitologjike në këtë pjesë, e cila në këtë pjesë ka rol vëzhgues dhe narrativ.



“TË PARËT DHE TË FUNDIT”

Produksion i Fondit të Teatrit për të Rinj, 2023

Data: 26-29.06.2023

Ora: 20:00

Vendi: Teatri Metropol
Organizuar nga TKEKS - FTR
Regjia: Marius Dhrami.
Autor: John Galsworth

“VERDI OFF

Aspetando Aida”

Data: 03-04.06.2023

Ora: 19:00

Vendi: Holli Koncertor, TKOBAP

Një sërë aktivitetesh të krijuara nga Giuseppe Verdi. Një udhëtim përgjatë të gjithë disiplinave të kompozuara nga mjeshtri, por duke përdorur një gjuhë më popullore dhe të gjitha këto aktivitete zhvillohen në hapësirat e përbashkëta, në teatër dhe në hapësira të gjelbra.

Verdi Off është një aktivitet, i cili e bën muzikën klasike më të prekshme nga publiku.



“VERDI CELEBRATION”

Java kombëtare e kulturës Italiane

Data: 04.06.2023

Ora: 20:00

Vendi: Skena e TKOBAP

Koncert i TKOB në bashkëpunim me Ambasadën Italiane



Interpreton: Orkestra Simfonike, TKOB

Soprano: Anna Pirozzi

Një nga sopranot dramatike më të suksesshme italiane, Anna Pirozzi, fama e së cilës kapërcen çdo kufi rajoni, do të sjellë me vokalin e saj brilant ariet më të bukura verdiane, në skenën gjigante të TKOB-së.

I cilësuar si një event unik për jetën artistike shqiptare, kjo mbrëmje do të përcjellë emocione të veçanta për publikun shqiptar e të huaj, me mbështetjen e Institutit Italian të Kulturë dhe Ambasadës Italiane, në kuadër të Javës Kulturore Italiane organizuar nga Ministria e Kulturës!

Nxitoni të merrni biletën tuaj, çdo ditë nga ora 10:00- 14:00 dhe nga ora 16:00-20:00!

OLEN CEZARI

Koncert
Java e Kulturës Italiane

Data: 04.06.2023
Ora: 20:00

Vendi: Teatri "Zihni Sako", Gjirokastër

Olen Cesari vjen në Gjirokastër
Një ndër artistët shqiptarë me famë botërore do të jetë në Gjirokastër, për të interpretuar në Teatrin "Zihni Sako", prej orës 19:00, më 4 qershor.
Cesari njihet për gjenialitetin e tij në violinë dhe padyshim është një performancë që nuk duhet humbur!
Ju presim në Gjirokastër!



"ENNIO MORRICONE- KONCERT SIMFONIK VOKAL ME MUZIKËN E KOMPOZITORIT"

Koncert Premierë



Java e Kulturës Italiane

Data: 05.06.2023
Ora: 20:00

Vendi: Skena e TKOBAP
Një koncert i ndërtuar mbi kompozimet e mjeshtrit të madh, Ennio Morricone, të njohura botërisht për stilistikën e përdorur për kolonat zanore të mbi 500 filmave dhe serialeve televizive.
Interpreton: Orkestra Simfonike, solistët dhe kori i TKOB.
Dirigjent: Benedetto Montebello.

IVA ZANICCHI

Koncert
Java e Kulturës Italiane

Data: 05.06.2023

Ora: 20:00
Vendi: Lungomare, Vlorë
Iva Zanicchi vjen në Vlorë!
Artistja e famshme italiane Iva Zanicchi do të performojë më 5 qershor në sheshin e Lungomares, e me siguri do të jetë një eksperiencë e paharrueshme për të gjithë ata që janë rritur e dashuruar me kulturën italiane!

"PAOLO FRESU"

Koncert recital
Java e Kulturës Italiane

Data: 06.06.2023

Ora: 20:00
Vendi: Skena e TKOBAP
Paolo Fresu – trombë, flikorno
Petra Magoni – soliste
Filippo Vignato – trombonë
Francesco Diodati – kitarë
Francesco Ponticelli – kontrabas, bas elektrik
Christian Meyer – bateri
Paolo Fresu interpreton David Bowie. Vetëm kaq do të mjaftonte për të "bërë bujë". Interpretimi i tij do të shoqërohet nga një kast yjesh, si Petra Magoni, Filippo Vignato, Francesco Diodati, Francesco Ponticelli dhe Christian Meyer.
Fresu dhe bashkëpunëtorët e tij përpunuan rreth tridhjetë pjesë, ku përfshihen "Life on Mars", "This Is Not America", "Warszawa", "When I Live My Dreams". Secili anëtar i grupit dha kontributin e vet tek aranzhimi, duke e veshur projektin me më shumë larmi dhe dinamizëm.
Petra Magoni si vokaliste gëzon liri më të madhe, por gjithsesi koncerti fokusohet te puna në skuadër. Duke iu rikthyer fjalëve të Fresut: "Bowie është një autor i pavdekshëm, i cili ka qenë gjithmonë pranë xhazit. Ne do të mundohemi të kemi respektin maksimal për artin e tij por edhe të jemi proaktiv, duke iu afruar me një qasje të re".

MARSELA CANTA FABER

Koncert
Java e Kulturës Italiane

Data: 07.06.2023

Ora: 21:00
Vendi: Qendra Kulturore, pranë Katedrales Ortodokse Tiranë
Hyrja e lirë.
Për herë të parë, për ju, një koncert i veçantë, ashtu sikurse është poezia dhe muzika e kantautorit/ poetit italian Fabrizio De Andrè.
Marsela Çibukaj së bashku me 11 muzikantë të mrekullueshëm.



"DON'T CRY FOR ME ARGENTINA"

Koncert simfonik, premierë

Data: 10.06.2023

Ora: 20:00
Vendi: Skena e TKOBAP
Një program unik, nën dirigjimin e Roberto Molinelli. Ky i fundit është dirigjent, orkestrues me famë botërore dhe ka një karrierë ndërkombëtare. Objektivi kryesor është afrimi, stimulimi i publikut dhe afrimi i tyre me muzikën klasike të ndërthurur me muzikën pop dhe rock.
Interpreton: Orkestra Simfonike
Dirigjent: Roberto Molinelli.



"RITUALI I JETËS"

Data: 12.06.2023
Ora: 20:00
Vendi: Skena e TKOBAP
Interpreton: Trupa e artistëve të Ansamblit Popullor dhe trupa e baletit të AP-së

"OPERA SOUL"

Data: 16.06.2023
Ora: 20:00
Vendi: Skena e TKOBAP
Solistë Lirik:ë Ramona Tullumani, Renisa Laçka dhe Igli Rapaj.

KONCERT I ANSAMBLIT POPULLOR

Hapja e sezonit turistik

Data: 17.06.2023

Ora: 19:00

Vendi: Sarandë

Koncert me këngë dhe valle popullore tradicionale shqiptare për fillimin e sezonit turistik.

"REQUIEM"

G.Verdi

Data: 17.06.2023

Ora: 20:00

Vendi: Prishtinë/ Kosovë

Artistët e TKOB në bashkëpunim me Filarmoninë e Kosovës do të realizojnë veprën madhështore "Requiem" të G.Verdi.

Dirigjent kori TKOB: Dritan Lumshi

Dirigjent Kori FK: Hajrullah Syla

Solist lirik i TKOB: Ivana Hoxha

KONCERT SIMFONIK

Filarmonia e Beogradit nën dirigjimin e Zubin Mehta-s

Data: 22.06.2023

Ora: 20:00

Vendi: Skena e TKOBAP

Një event i rrallë dhe unik. Në nder të 100-vjetorit të saj të krijimit vjen në Tiranë një ndër filarmonitë më të mira në Europë dhe Ballkan, për të realizuar një koncert simfonik nën dirigjimin e dirigjentit me famë botërore Zubin Mehta.

Programi: L. van Beethoven: Symphony No. 7 H.

Berlioz: Symphonie Fantastique



“AIDA”

Opera – Premierë

Data: 23-24.06.2023; 26-27.06.2023

Ora: 20:00

Vendi: Skena, TKOBAP

Produksioni madhështor i operës “Aida“, i cili mban autorësinë e regjisorit me famë botërore Franco Zeffirreli, vjen në TKOB si një bashkëpunim me teatrin e Varnës, Bullgari.

Dirigjent: Jacopo Sipari di Pescasseroli

Regjia: Franco Zeffirelli / Stefano Trespidi

As/regjisor: Ada Gurra

“OPERA ON TOUR”

“Folk Tour Albania”

Data: 30.06.2023

Ora: 19:00

Vendi: Përmet

Organizuar nga TKOBAP

Në kuadër të hapjes së sezonit turistik, koncert me këngë dhe valle popullore, tradicionale shqiptare.

FESTIVALI FOLKLORIK KOMBËTAR I GJIROKASTRËS

Data: 24.06.2023-1.07.2023

Vendi: Gjirokastër

Pas 8 vjetësh rikthehet në edicionin e 11-të Festivali Folklorik Kombëtar i Gjirokastrës. Përgjatë ditëve të festivalit do të interpretojnë rreth 1200 artistë nga 12 qarqet e vendit, por edhe nga arbëreshët e Italisë, shqiptarët e Greqisë, Zvicrës, ShBA-së etj. Krahas programit të festivalit do të ketë edhe shumë aktivitete satelite, që do të zhvillohen në të gjithë qytetin, koncerte, ekspozita, aktivitete artizanati etj.



“1989 PARA DHE PAS”.

Ekspozitë

Data: 01- 10.06.2023

Ora: 12:00

Vendi: Muzeu Kombëtar i Përgjimeve “Shtëpia me Gjethe”
Organizuar nga Qendra e Muzeve të bashkisë së Bukureshtit, Rumani dhe Muzeu Kombëtar i Përgjimeve “Shtëpia me Gjethe”
Përgjatë dhjetë ditëve Qendra e Muzeve të bashkisë së Bukureshtit, Rumani dhe Muzeu Kombëtar i Përgjimeve “Shtëpia me Gjethe” sjellin ekspozitën “1989 para dhe pas”.

“ITALIA NË TELAJO”

Ekspozitë

Data: 02.06.2023

Ora: 10:30



Vendi: Galeria e Arteve “Edward Lear”, Berat
Në kuadër të Javës Italiane të Kulturës në Galerinë e Arteve “Edward Lear” hapet ekspozita “Italia në telajo”, me vepra e tablo të realizuara në një marrëdhënie të drejtpërdrejtë nga natyra në Itali, të cilën artistët e kanë parë si vendin e adhuruar të artit.
Ekspozita është bashkëpunim i Konsullatës së Përgjithshme të Italisë në Vlorë, bashkisë Berat dhe Grupit të PleiAir-it shqiptar.
Në ekspozitë janë përzgjedhur 35 vepra me pamje të frymëzuara nga natyra mahnitëse në Italinë e adhuruar, nga qytetet më të njohura, qendra të rëndësishme të artit dhe kulturës botërore Roma, Firence, Milano, Venecia, veçanërisht nga komunat arbëreshe të realizuara gjatë udhëtimeve individuale apo në kolonitë nga artistët Kujtim Buza, Buron Kaceli, Nikolin Ivanaj, Pashk Përvathi, Agim Kadillari, Agron Polovina, Sadik Kasa, Vangjo Vasili, Xheneta Kadillari, Adrian Cene, Rikarda Nova, Zaim Elezi, Anila Zajmi dhe Xhovana Zekollari.

“URAT”

Gjergj Meta-Xhoxho

Data: 02-14.06.2023

Ora 11:30

Vendi: Galeria e Artit, Tiranë (GAT)
Gjergji Meta dhe urat e Venecias, si ura të reja komunikimi midis njerëzve…

“SAFET E GJYLZADE DOKLE”

Vendi: Muzeu Kombëtar i Fotografisë “Marubi”
Kurator: Lek M. Gjeloshi
Muzeu “Marubi” prezanton ekspozitën personale të fotografëve Safet e Gjylzade Dokle, kuruar nga Lek M. Gjeloshi. Aktiviteti fotografik i bashkëshortëve Safet e Gjylzade Dokle u zhvillua në Borje të rrethit të Kukësit e më gjerë, duke përshkuar një hark kohor 40 vjeçar, nga vitet ’30 deri në fillim të viteve ’70. Në koleksionin e tyre fotografik dokumentohet historia politike, jeta shoqërore, ritualet e ndryshme dhe aspektet tradicionale të Shqipërisë Verilindore të asaj kohe.
Ky koleksion, i cili përbëhet nga rreth njëzet mijë negativë, është më i madhi i dhuruar mbas viteve ‘90 në arkivin e Muzeut Kombëtar të Fotografisë “Marubi”.

“FACES OF UNCERTAIN TIME”

MIKEL TEMO
Ekspozitë

Data: Deri në 17, 06, 2023

Vendi: Gallery70 te Qendra Toptani, Tiranë
Gallery70 ka kënaqësinë të prezantojë një ekspozitë personale me vepra të reja nga Mikel Temo.
[...] Autoportretet e Mikel Temos, të tensionuara maksimalisht, me gjestikulacione të skajshme, duan të lëshojnë një klithmë. Portreti i tij i shtrembëruar, më shumë i drejtohet vetvetes si një akt vetëçlirimi sesa është një transmetim për diku i dhimbjes. Ato çlirojnë një tmerr të papërshkrueshëm. Gjesti i tij të kall krupën. Të gjitha elementet anatomike të mimikës, në trajta të skajshme, të pështjelluara, i japin formë konkrete vetë ankthit, krizës, dhimbjes, dëshpërimit, vetmisë ekzistenciale. Mikel Temo në autoportretet e tij nuk i bën asnjë makijazh dhimbjes. Ai deformon realitetin për të nënvizuar gjendjen. Do të ishte e pasinqertë që artistët të shihnin vetëm anën e bukur të jetës. Mikel Temo bën atë që bënë ekspresionistët, duke bërë objekt të veprës së tij në mënyrë të drejtpërdrejtë vuajtjet njerëzore, depresionin, melankolinë, revoltën, varfërinë, dhunën, zemërimin; ai priret të shohë në mënyrë të ndershme realitetin. Ai vetë bëhet pasqyra e kësaj game gjendjesh, duke vënë në qendër të këtij cikli vetëportretin. Është, pa dyshim, një prurje e beftë dhe e suksesshme në pikturën shqiptare moderne.
(shkëputur nga teksti i Luan Topçiut)

FASHION PANORAMA – THE ITALIAN NEW WAVE

Data: 02.06.2023

Ora: 20:30
Vendi: Kolonadat në Sheshin "Nënë Tereza"
Organizuar nga: Instituti Italian i Kulturës dhe IT

Fashion Panorama – The Italian New Wave është një projekt i Ministrisë së Punëve të Jashtme dhe Bashkëpunimit Ndërkombëtar, me kurator Vogue Italia. Ekspozita lindi me synimin për t'i dhënë zë dhe shikueshmëri gjeneratave të reja të stilisteve dhe stilistëve italianë, duke përçuar gjerësisht vizionin dhe punën e tyre.

Synimi i ekspozitës është të rrëfejë modën bashkëkohore italiane përmes vizionit dhe punës së 10 stilistëve - ACT N°1, Gisèle, Cormio, Lessico familiare, Magliano, Marco Rambaldi, Medea, Panconesi, Niccolò Pasqualetti, SSHEENA - të cilët, përkrah ripërpunimit të traditave artizanale në formë rishtare dhe me gjuhë e metoda novatore, kanë mundur të ruajnë një marrëdhënie të fortë dhe të integruar me industritë e tjera të lidhura me kulturën dhe krijimtarinë italiane, si dhe të trajtojnë në mënyrë origjinale aspirata dhe tema të dashura për shoqërinë bashkëkohore.

Fashion Panorama – The Italian New Wave përmban një ekspozitë fotografish, të krijuara enkas për këtë projekt, si dhe imazhe arkivore, të shoqëruara me materiale audio-vizuale, kushtuar punës së 10 talenteve të përfshirë.

Projekti është pjesë e një game më të gjerë nismash origjinale të promovimit të integruar, të promovuara nga Ministria e Punëve të Jashtme, për të projektuar jashtë vendit një imazh organik, të shumanshëm dhe aktual të Sistema Italia. Fashion Panorama – The Italian New Wave thekson se si sektori i modës luan një rol kyç në vendin tonë, është një shembull i të qenit dhe sjelljes si "italian", si dhe një burim frymëzimi për sistemin tonë prodhues dhe krijues.



‘EKRANI I ARTIT’

Festivali i filmave eksperimentalë dhe videoartit

Data: 31 maj - 4 qershor

Vendi: Qendra Rinore Atelie, Shkodër
Organizuar nga: Fondacioni ‘Art House’
Event paralel me videoart nga artistë të rinj
Kuratorë: Elsamina Musiq, Xhulian Millaj



Kjo iniciativë përfshin një sërë ve-prash vizuale në mediumin e videos që qëndrojnë individualisht, por gjithashtu kontribuojnë në një rrëfim apo temë më të gjerë. Duke ek-sploruar identitete dhe mundësi të ndryshme vizuale, ky projekt ofron perspektiva të shumta mbi realitetin aktual, duke përfshirë aspektet fizike, metafizike dhe sociopolitike.
Çdo njësi kuptimore e pavarur of-ron një dritare unike në këtë realitet, por të marra së bashku ato krijojnë një portret më të pasur dhe më kompleks të botës ku jetojmë. Duke u angazhuar me këto vepra, ne mund të fitojmë njohuri për dimensione të ndryshme të ekzistencës sonë dhe ndoshta edhe të gjejmë mënyra të reja për të kuptuar dhe për t’iu përgjigjur sfidave me të cilat përbal-lemi.
Në përgjithësi, ky projekt është një mënyrë intriguese dhe interesante për të ek-sploruar kryqëzimet e artit, kulturës, shoqërisë dhe për të krijuar një hapësirë për dialog dhe reflektim mbi disa nga çështjet më urgjente të kohës sonë.

01.06.2023

Alcaeus Spyrou, Anina, 19’48”, 2018
Jozefina Vokrri, Untitled, 1’43”, 2021
Floida Skraqi, Sisyphus’ Labour, 12’51”, 2020

02.06.2023

Azize Ferizi, 1637, 5’31”, 2021
Renea Begolli, Waiting Game, 5’15”, 2020
Inda Sela, Stok, 3’36”, 2021
Elsaida Musiq, Oasis, 2’20”, 2020
Joan Kamberaj, Abeo, 6’, 2015

03.06.2023

Enxhi Mehmeti, How to not be a bird, 2'51", 2023
Laureta Hajrullahu, Touching Systems. Can't they see?! IT'S ALL CHROMA-GREEN, 1'45", 2022
Anna Ehrenstein, Nationstate As Instagram Influencer, 19'54", 2022

04.06.2023

Gerta Xhaferaj, Kurban, 3'28", 2021
Kristanja Çene, Virgin Killer, 5'45", 2021
Agrina Vllasaliu, The Ice Palace, 5'18", 2022
Kreshnik Arifi, incizim në Goteborg Liseberg 1999, 13'5", 2022. Për herë të parë festivali do të ketë një ditë fokusi të dedikuar filmit dhe videoartit në Suedi. Gjithashtu, aktiviteti rikthehet në hapësirën e 'Kinema Millenium', vendin nga ku nisi udhëtimin e tij gjashtë vite më parë. 'Ekrani i Artit' do të vazhdojë me rolin e tij të pazëvendësueshëm si pikë takimi për artistë të rinj shqiptarë dhe kuratorë e profesionistë nga bota përmes prezantimit të portofolave artistikë, si dhe me aktivitetin edukativ dhe punëtorinë me fëmijë.



'Art House' ka kënaqësinë të prezantojë drejtorin artistik të këtij edicioni, kuratorin dhe kritikun e mirënjohur Edi Muka, i cili ka shprehur entuziazmin e tij për ftesën dhe angazhimin në 'Ekrani i Artit' 2023.

"ATELIER 2023"

Ekspozitë e studentëve të vitit të parë

Data: 31 maj- 04. 06.2023

Vendi: Galeria FAB, në Fakultetin e Arteve të Bukura
Kuruar nga As.lektor Artan Buca, Orlis Vathi, Gentjan Tabaku
Studentët pjesëmarrës
Adela Gjoni, Aila Baçi, Albi Dulaj, Danjel Doçi, Denisa Balla, Edmea Kerrni, Enea Sulejmani, Ermal Subashi, Luis Ndreko, Lulisa Kateshi, Orianda Prifti, Ruslana Hala, Sergjino Keqi, Daniela Meta, Dario Martini, Grejs Hitaj, Iger Nuellari, Laura Seferkolli, Orgit Hyzellari, Renid Tosuni, Sara Topi, Xhoana Prifti, Elona Elezi, Albjon Hysaj, Anisa Telha, Arsela

Gecaj, Brisilda Tare, Ergis Hoxha, Kristina Bozha, Raina Kasaj, Ada Hasani, Arsida Hasaj, Ersjada Ukcamaj, Ildi Stafaj, Ilva Nelaj, Kessy Buqeza, Laura Bezati, Rosela Tarja, Anxhelina Deliu, Erlinda Derri, Elona Murati, Franklin Pelari, Glejda Lesi, Halim Pashkos, Klarisa Muça, Myrtezan Shpata, Olisa Sinani, Suada Malaj, Dea Boba, Paola Kafa, Aleksander Gjokaj, Klejdi Toçi, Eglantina Sulaj, Teljan Baçi, Ergys Reçi, Klerti Ndoj, Leonardo Bica, Frida Shehu.

REZIDENCA ME DYER TË HAPURA

Java e Kulturës Italiane

Data: 5.06.2023

Ora: 10:00-11:30; 11:30-13:00

Vendi: Rezidenca Italiane

Më 5 qershor, ju presim në Rezidencën Italiane, për të realizuar vizita të udhëhequr nga artistë shqiptarë, punët e të cilëve gjenden të ekspozuara brenda ndërtesës. Në bashkëpunim me Harabel Contemporary, artistët Ledia Konstandini, Artan Shabani dhe Adrian Cene, do t'ju shoqërojnë në event.



"DEA INTERNATIONAL FILM FESTIVAL"

Data: 19- 21.06.2023

Ora: 20:00

Vendi: Arturbina, salla 150

SHPALLJA E THIRRJES SË FONDIT TË KRIJIMTARISË LETRARE PËR FËMIJË

Data: 01.06.2023

Ora: 09:00

Vendi: Qendra Kombëtare e Librit dhe Leximit

QKLL-ja mbështet procesin krijues të autorëve të letërsisë për fëmijë, si një letërsi e domosdoshme në rritjen dhe edukimin e brezave që vijnë. “Fondi për mbështetjen e krijimtarisë letrare për fëmijë”, do të vijojë të jetë ndër projektet bazë dhe të përvitshme të QKLL-së. Thirrja u drejtohet autorëve mbi 18 vjeç në gjininë e prozës dhe poezisë për fëmijë dhe do të qëndrojë e hapur deri më datë 20.06.2023.



ÇMIMI ‘LUMO SKËNDO’”

Qendra Kombëtare e Librit dhe Leximit

Vendi: QKLL

Data: 01.06.2023

Ora: 18:00

Vendi: Hotel Tirana

Shpallja e Çmimit ‘Lumo Skëndo’.

Juria e Çmimit “Lumo Skëndo” do bëjë publik emrin e fituesit të çmimit të këtij edicioni, si edhe motivacionin e dhënies së çmimit. Finalistët e këtij edicioni janë: Aleksandër Çipa, Ben Blushi, Eleni Laperi, Evarist Beqiri e Mero Baze. Juria përbëhet nga Belina Budini, Uran Butka, Teuta Toska, Ardit Bido dhe Monika Stafa.

“PREZANTIMI I ANTOLOGJISË ‘GIRL OF MONDAY”


Data: 02.06.2023

Ora: 18:00

Vendi: Qendra Kombëtare e Librit dhe Leximit

Aktivitet letrar mbi prezantimin e antologjisë “Girl of Monday”, me pjesëmarrjen e poetëve Alban Balla, Jantine Dijkstra, Gerard van Hameren, Juan Heinsohn Huala, Liridon Mulaj, Marco Nijmeijer, Shakila Azizzade, Albana Shala, Leo Stilma, Ndue Ukaj, Arjola Zadrima.





SHPALLJA E FITUESVE TË FONDIT TË PËRKTHIMIT LETRAR NGA GJUHA SHQIPE NË GJUHË TË HUAJ

Data: 07.06.2023

Ora: 11:00

Vendi: Qendra Kombëtare e Librit dhe Leximit

Çdo vit Qendra Kombëtare e Librit dhe Leximit mbështet përkthimin e 6 veprave shqip të përkthyera më mirë në gjuhë të huaja. Juria, e përbërë nga Ben Andoni, Esmeralda Kromidha, Irena Prici, referuar kritereve dhe vlerësimit të eksperteve do të shpallë 6 veprat fituese për vitin 2023.

TAKIM ME AUTORIN KROAT MILJENKO JERGOVIC

Data: 14.06.2023

Ora: 11:00

Vendi: Qendra Kombëtare e Librit dhe Leximit

Qendra Kombëtare e Librit dhe Leximit në bashkëpunim me Shtëpinë Botuese “Dituria” organizojnë takimin letrar me autorin kroat Miljenko Jergovic, i cili do të zhvillojë një bashkëbisedim me lexuesit shqiptarë.

3-VJETORI I NDARJES NGA JETA TË SHKRIMTARIT MOIKOM ZEQO

Data: 15.06.2023

Ora: 11:00

Vendi: Durrës

Organizuar nga Qendra Kombëtare e Librit dhe Leximit

Aktivitet përkujtimor me rastin e ndarjes nga jeta të shkrimtarit Moikom Zeqo.

"PETRO MARKO NË LETRAT SHQIPE"

Në kuadër të vitit 2023 si viti i Petro Markos

Data: 23.06.2023

Ora: 11:00

Vendi: Hotel Tirana

Organizuar nga Qendra Kombëtare e Librit dhe Leximit

Në kuadër të shpalljes së vitit 2023 si "Viti i Petro Markos", Qendra Kombëtare e Librit dhe Leximit do të organizojë aktivitetin me temë "Petro Marko në letrat shqipe". Të ftuar në këtë takim do të jenë shkrimtarë, personalitete të letrave shqipe, miq dhe dashamirës të veprës tij.

86-VJETORI I LINDJES SË SHKRIMTARIT REXHEP QOSJA

Data: 25.06.2023

Ora: 11:00

Vendi: Qendra Kombëtare e Librit dhe Leximit

Me rastin e 86-vjetorit të lindjes së akademikut, shkrimtarit, studiuesit Rexhep Qosja, Qendra Kombëtare e Librit dhe Leximit do të organizojë një aktivitet letrar, me pjesëmarrjen e disa prej personaliteteve të njohura në fushën e letrave, si shkrimtarë, studiues e dashamirës së shkrimtarit.

DITA NDËRKOMBËTARE E FËMIJËVE

Data: 01.06.2023

Ora: 11:00

Vendi: Muzeu Historik Kombëtar

Organizuar nga: Muzeu Historik Kombëtar dhe shkollat e Tiranës

Në atriumin e muzeut (oborrin e brendshëm), do të organizohen lojëra popullore, duke u përpjekur të ruhet tradita, në bashkëpunim me shkollat e Tiranës.

KONCERT FESTIV ME RASTIN E 1 QERSHORIT

Data: 01.06.2023

Ora: 18:30

Vendi: Salla e kinemasë, Kristal Center

Organizuar nga Qendra Kombëtare e Kulturës për Fëmijë

Me pjesëmarrjen e fëmijëve të kursit të këngës, baletit, pikturës

"BORËBARDHA DHE SHTATË XHUXHËT"

Shfaqje teatrale me kukulla.

Data: 01.06.2023

Ora: 13:00

Organizuar nga Teatri i Kukullave

Vendi: Pallati i Brigadave

Data: 26.06.2023

Ora: 19:00

Vendi: Himarë

Data: 27.06.2023

Ora: 19:00

Vendi: Sarandë

Data: 28.06.2023


Ora: 19:00

Vendi: Qeparo

Regjia: Aldjon Matarangasi.

Aktorët: Jorida Meta.

Kohëzgjatja 35 min.



"TK RIN ART 2023

Shfaqje & Ndarja e çmimeve për kategoritë:
Shfaqja më e mirë

Aktori më i mirë (Protagonist)
Aktorja më e mirë (Protagoniste)
Aktori më i mirë (Joprotagonist)
Aktorja më e mirë" (Joprotagoniste)

Data: 02.06.2023

Ora: 13:00
Vendi: Salla "Central 400" ArTurbina, Teatri Kombëtar, Tiranë
Shfaqja "I sëmuri për mend"
Autor: Molier
Regjisor: Denis Kurushi
Interpretojnë:
Nxënësit e shkollës "Andon Zako Çajupi".
Edicioni VI i Festivalit Teatror për të rinj, do të angazhojë 9 regjisorë të rinj, të cilët do të krijojnë 9 produksione me elementët/nxënësit më të mirë nga 9 gjimnaze të kryeqytetit. Aktiviteti funksionon në formë konkursi, ku në fund do të shpallen dhe fituesit në kategori të ndryshme, nga juria artistike, e përbërë nga aktorë profesionistë brenda strukturës së Teatrit Kombëtar.

"SHFAQJE ME NUMRA REPERTORI"

Cirk

Data: 03-04.06.2023

Ora: 11:00
Vendi: Cirku Kombëtar, Qendra "Kristal"
Numra artistikë nga 7 profilet e cirkut si kloun, lojëra interaktive me fëmijët nga klouni, numra artistikë me kafshë, ekuilibristë, zhonglerë, numra ajri dhe vertikalistë.

"ROZA DHE FATI"

Data: 02.06.2023

Ora: 10:30
Vendi: Salla e koncerteve "Ramiz Kovaçi", Krujë
Data: 03.06.2023
Ora: 10:30
Vendi: Teatri "Skampa", Elbasan
Organizuar nga Teatri i kukullave, Qendra Kombëtare e Kulturës për Fëmijë
Shfaqje teatrale me kukulla
Regjia: Medi Gurra.
Aktorët: Elidon Alika, Esmeralda Kame, Aleksandër Grami, Flori Kokona, Ilia Kaçi
Kohëzgjatja 40 min.

“ARKEOLOGU I VOGËL”

Data: 08.06.2023

Ora: 10:00

Vendi: Muzeu Historik Kombëtar

Organizuar nga Muzeu Historik Kombëtar dhe Kampi veror

Fëmijët, të shoqëruar edhe nga mësuesja e tyre, si fillim do të bëjnë një guidë në muze. Ata do të njihen imtësisht me Pavijonin e Lashtësisë dhe me objektet e zbuluara në vite prej ekspeditave arkeologjike. Më pas nxënësit në atrium do të zhvillojnë pjesën tjetër të aktivitetit, që ka të bëjë me imitimin e gërmimeve dhe gjetjen e objekteve antike. Pas gërmimeve fëmijët do të vizatojnë objektet e gjetura, si dhe do të plotësojnë disa fjalëkryqe me terma, që përdoren në arkeologji.

“RRUGËTIMI YNË”

Ekspozitë pikture

Data: 10.06.2023

Ora: 11:00

Vendi: Kalaja e Tiranës


Organizuar nga Qendra Kombëtare e Kulturës për Fëmijë

Qendra Kombëtare e Kulturës për Fëmijë organizon një ekspozitë me punime në pikturë nga fëmijët e kursit të pikturës të QKKF.

“HIRUSHJA”

Teatri i kukullave

Përralla e njohur vjen në një shfaqje teatrale për fëmijë.



Data: 14.06.2023

Ora: 11:30

Vendi: Përrenjas

Data: 15.06.2023

Ora: 11:00

Vendi: Ersekë

Data: 16.06.2023

Ora: 19:00

Vendi: Pogradec

Regjia: Klajd Ymeri

Aktorët: Esmeralda Kame, Aleksandër Grami, Ermonela Alikaj, Ilia Kaçi, Albana Koçaj.

Kohëzgjatja 45 min.

EKSPOZITË PIKTURE

Data: 17.06.2023

Ora: 11:00

Vendi: Liqeni Artificial i Tiranës
Organizuar nga Qendra Kombëtare e Kulturës për Fëmijë
Ekspozitë me punime në pikturë nga fëmijët e kursit të pikturës të QKKF.
Kohëzgjatja 60 min.

"E KA KUSH E KA- MOS U NXEH"

Data: 20.06.2023

Ora: 10:00

Vendi: Muzeu Historik Kombëtar
Organizuar nga Muzeu Historik Kombëtar dhe Kampi veror
Të njohim trashëgiminë kulturore nëpërmjet lojës "Mos u nxeh"

"PRINCESHAT DHE BIZELJA MAGJIKE"

Teatri i kukullave

Data: 08.06.2023

Ora: 10:30; 11:00

Vendi: Cërrik

Data: 21.06.2023

Ora: 10:30

Vendi: Rubik
Shfaqje teatrale me kukulla
Regjia: Xhuliano Brisku
Aktorët: Jorida Meta, Madi Selimi, Elidon Alika.
Kohëzgjatja 40 min.



LOJA "E KA KUSH E KA-XHUBLETA"


Data: 26.06.2023

Ora: 10:00

Vendi: Muzeu Historik Kombëtar
Organizuar nga Muzeu Historik Kombëtar dhe Kampi veror
Aktiviteti synon të përcjellë njohuritë mbi trashëgiminë tonë kulturore me broshurën "Xhubleta".

“MAÇOKU ME ÇIZME”

Shfaqje teatrale me kukulla



Data: 13.05.2023

Ora: 11:30

Salla “Tonin Harapi”, Liceu artistik “Jordan Misja”

Data: 14.05.2023

Ora”10:30; 11:30

Salla “Tonin Harapi”, Liceu artistik “Jordan Misja”

Regjia: Paolo Comentale.

Aktorët: Elidon Alika, Jorida Meta, Albana Koçaj, Ermonela Alikaj, Aleksander Grami, Madi Selimi, Flori Kokona.

Kohëzgjatja 35 min.

Teatri i kukullave

EKSPOZITË “MBRESA”

Data: 18-26.05.2023

Ora: 11:00

Muzeu Kombëtar i Përgjimeve “Shtëpia me Gjethe”

Ekspozitë me punimet artistike të nxënësve pjesëmarrës në programin “Mbresa”

MUZEU KOMBËTAR I PËRGJIMEVE “SHTËPIA ME GJETHE”

“Finalizimi i projektit artistik “Mbresa”

Ceremonia e ndarjes së çmimeve”.

Data: 23.05.2023

Ora: 17:00

Muzeu Kombëtar i Përgjimeve “Shtëpia me Gjethe”

Ceremonia finale e edicionit “Mbresa”, ku do të ndahen çmimet fituese.

Muzeu Kombëtar i Përgjimeve “Shtëpia me Gjethe”

“GJIRAFAT NUK VALLËZOJNË”

(shfaqje për fëmijë)

Datat: 13-14, 20-21, 27-28.05.2023

Ora: 10:30

TKEKS, Arturbina

“Gjirafat nuk vallëzojnë” ka në qendër Geraldin, një gjirafë që nuk dinte të kërcente. Geraldi ka katër këmbë të majta, gjunjët i mban gjithmonë përkulur dhe këmbët i ka të ngurta.

Gjatë festës së përvitshme të xhunglës, të gjitha kafshët interpretuan shumë bukur dhe u tallën me Geraldin e gjorë, duke qeshur dhe duke e nxjerrë nga pista e kërcimit.

Geraldi u mërzit, por kur po largohej ai takon një gjinkallë. Kjo krijesë e vogël dhe e mençur i jep një këshillë, duke i thënë se “Ndonjëherë kur je ndryshe, thjesht të duhet një këngë e ndryshme”. Duke dëgjuar tingujt e pemëve dhe erës, Geraldi fillon të lëvizë. Me muzikën e natyrës përreth tij, ai lëkundet dhe vallëzon me delikatesë. Falë ndihmës së gjinkallës, Geraldi mëson të vallëzojë dhe i habiti të gjitha kafshët e xhunglës.

“ROSAKU I SHËMTUAR”



Data: 23.06.2023

Ora: 10:30 dhe 11:30

Vendi: Teatri “Aleksandër Moisiu”, Durrës

Shfaqje teatrale me kukulla.

Regjia: Paolo Comentale

Aktorët: Jorida Meta, Albana Koçaj, Ermonela Alikaj, Elidon Alika, Esmeralda Kame, Aleksandër Grami, Madi Selimi, Flori Kokona, Ilia Kaçi.

Kohëzgjatja 40 min..

Teatri i kukullave

“MUZEU IM”

Muzeu Historik Kombëtar

Data: 25.05.2023

Ora: 11:30

Objektet e vjetra që ruajmë në shtëpi marrin vlera muzeale me kalimin e kohës. Historitë e tyre i tregojmë në muze.

Muzeu Historik Kombëtar